



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.DH.Shk.II.nr.1620/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit SE-FA Hurriyet Mh., se seli në Stamboll, Republika e Turqisë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit L.M., avokat nga Ferizaj, kundër debitorit “The North Unicorn” L.L.C, me NUI:810112186 të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A.K. dhe G.V., avokat në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1797/22 të datës 29.09.2023, me datë 01.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të kreditorit SE-FA Hurriyet Mh., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1797/22 të datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1797/22 të datës 29.09.2023 në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të “The North Unicorn” L.L.C, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.227/22 të dt. 21.04.2022, të Përmbartuesit Privat Besnik Aliu.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka theksuar se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë të gjitha provat të cilat gjenden në shkresë të lëndës andaj qëllimi kryesor i kreditorit është vetëm prolongimi i procesit përmbartimor. Andaj i ka propozuar gjykatës

që të refuzoj në tërësi ankesën e kreditorit dhe të vërtetoj Aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës KPPP.nr.1946/22 të datës 29.06.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori SE-FA Hurriyet Mh., me datën 20.04.2022 ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë në bazë të dokumentit të besueshëm dhe atë faturës SEF2000000302 të datës 27.03.2020, duke urdhëruar debitorin t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 2,840.00 €, së bashku me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data e secilës faturë veç e veç deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi Privat Besnik Aliu me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.227/22 të dt. 21.04.2022 e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitorin brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim përmes të cilit ka kontestuar në tërësi urdhrin për shkak se propozimi për përmbartim është mbështetur dokumentin në gjuhë të huaj e cila për debitorin është e panjohur dhe se e njëjta nuk i plotëson kushtet ligjore sipas UA nr.15/2010 dhe nuk është e nënshkruar nga debitorin.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar thëniet e debitorit si të pambështetura në prova dhe ka theksuar se kreditori ka kërkuar nga debitorin përmbushjen e obligimit sipas faturës mirëpo nuk ka hasur në mirëkuptimin e tij dhe rrjedhimisht është detyruar të inicioj procedurë përmbartimore. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar Gjykatës ta refuzoj prapësimin si të pabazuar, urdhri të mbetet ne fuqi.

Gjykata Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1797/22 të datës 29.09.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit "The North Unicorn" L.L.C të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.227/22 të dt. 21.04.2022 të Përmbartuesit Privat Besnik Aliu.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se propozimi për përmbartim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor përmbartim të meta pasi që në propozim nuk është treguar dokumenti origjinal apo kopje vërtetuar ashtu siç përcaktohet me nenin 38 paragrafi 1 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se faturat si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilave është lejuar përmbarimi nuk janë nënshkruar nga ana e debitorit, dokumenti në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbarimore nuk është në origjinal apo kopje të vërtetuar dhe rrjedhimisht të njëjtat nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm për përmbarim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 37 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga fatura respektive, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.Shk.II.nr.1620/23, me datë 01.03.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**